

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. nr. 12/2010

10 dhjetor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Nikolay Entchev, si kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët e EULEX-it Christine Lindemann-Proetel dhe Klaus Jung, si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Zane Ratniece, si mbajtëse e procesverbalit, në çështjen penale kundër:

E.K., i akuzuar, sipas aktakuzës së Prokurorit publik PP nr. 404/09, të paraqitur më 18 shkurt 2010, për tentim vrasje e rëndë, në bazë të nenit 147 pika 10 në lidhje me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve, në bazë të nenit 328 paragrafi (2) të LPK-së, dhe

S.B., i akuzuar, sipas aktakuzës së prokurorit publik PP nr. 404/09, të paraqitur më 18 shkurt 2010, për nxitja për kryerjen e tentim vrasje së rëndë, në bazë të nenit 147 pika 10 në lidhje me nenet 20 dhe 24 të LPK-së dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorimi të paautorizuar të armëve, neni 328 paragrafi (2) i LPK-së;

Pas mbajtjes së seancave kryesore të gjykimit të hapura për publikun më 17, 18, 19, 23 dhe 30 nëntor dhe 9 dhjetor 2010, në prani të akuzuarit **E.K.**, avokatit të tij mbrojtës **A**, të akuzuarit **S.B.**, avokatit të tij mbrojtës **B**, të prokurores publike të EULEX-it Neeta Amin (përveç se në seancën më 9 dhjetor 2010 ishte i pranishëm prokuror publik i EULEX-it Petr Klement), të palës së dëmtuar **C.D.**, të përfaqësuesit të tij të autorizuar avokatit **C** (përveç se në seancën më 09 December 2010 pala e dëmtuar ishte e përfaqësuar nga avokati **D**);

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues për të marrë vendim të mbajtur më 09 dhjetor 2010, në bazë të nenit 392 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpalli më 10 dhjetor 2010 publikisht dhe në prani të dy të akuzuarve, të avokatëve të tyre mbrojtës, prokurorit publik të EULEX-it Petr Klement, palës së dëmtuar dhe përfaqësuesit të autorizuar avokatit **D**, këtë

AKTGJYKIM

A.

I akuzuari **E.K.**, emri i babait , emri i nënës , mbiemri i vajzërisë , i lindur në në Mitrovicë, ashkali i Kosovës, me banim në rrugën " " nr. , në Mitrovicë, aktualisht në ndihma sociale, i martuar, ka fëmijë, e ka të kryer shkollën fillore, në paraburgim prej 04.12.2009 deri 17.08.2010 dhe pastaj në arrest shtëpiak;

SHPALLET I PAFAJSHËM

Për akuzën e tentim vrasje së rëndë, sipas nenit 147 pika 10 në lidhje me nenin 20 të LPK-së;

Sepse nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se **E.K.** ka synuar ta privojë nga jeta **C.D.** , inspektor ky pranë Agjencisë së veterinarisë dhe të ushqimit e Kosovës, kur më 24.10.2009, rreth orës 19:00 në fshatin Shupkocv, në kryqëzimin e rrugëve "Kalabria" dhe "Brigada 141" mbi urë, **E.K.** ka gjuajtur me pushkë automatike AK-47, numri serik xxxxxx në drejtim të **C.D.** dhe ka goditur me dy të shtëna automjetin zyrtar Nissan Terrano, në ngjyrë të bardhë, me pllakën e regjistrimit xxxxxx , në të cilin **C.D.** po largohej nga Mitrovica në drejtim të Prishtinës;

Prandaj, në përputhje me nenin 390 pika 3 të KPPK-së **E.K.** lirohet nga kjo akuzë

SHPALLET FATOR

Sepse **E.K.** më 24.10.2009, rreth orës 19:00 në fshatin Shupkocv, në kryqëzimin e rrugëve "Kalabria" dhe "Brigada 141", mbi urë, ka shtënë me pushkë automatike AK-47, numri serik xxxxxx në drejtimin të **C.D.** , inspektor ky pranë Agjencisë së veterinarisë dhe të ushqimit e Kosovës, dhe goditi me dy të shtëna të automjetin zyrtar Nissan Terrano, i ngjyrës së bardhë, me pllaka të regjistrimit xxxxxx , në të cilin **C.D.** po largohej nga Mitrovica në drejtim të Prishtinës;

Duke bërë kështu, i akuzuari **E.K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve, nga neni 328 (1) i LPK-së;

PRANDAJ, i akuzuari **E.K.**

DËNOHET

Me tre (3) vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga 04.12.2009 deri 17.08.2010 dhe më pas nën arrest shtëpiak do të llogaritet në pajtim me nenin 73 paragrafi (1) të LPK-së.

B.

I akuzuari **S.B.**, emri i babait , i nënës , mbiemri i vajzërisë , i lindur në në Mitrovicë, shqiptar i Kosovës, me vendbanim në rrugën ' nr. , Mitrovicë, punonjës në një kompani të shpeditonit të mallrave, të ardhurat mesatare mujore euro, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, në paraburgim prej 04.12.2009 deri më 17.08.2010 dhe pastaj në arrest shtëpiak

SHPALLET FAJTOR

Sepse **S.B.** i kërkoi **E.K.** të gjuajë me armë në palën e dëmtuar **C.D.**, inspektor ky pranë Agjencisë së veterinarisë dhe të ushqimit e Kosovës, ia siguroi për këtë qëllim **E.K.** pushkën automatike AK-47, me numër serik xxxxxx, dhe më 24.10.2009, kur rreth orës 18:50 **C.D.** po lëshohej nga puna në terminalin doganor të Mitrovicës, në automjetin zyrtar Nissan Terrano, me ngjyrë të bardhë, numri i pllakave të regjistrimit xxxxxx, në drejtim të Prishtinës, e njoftoi **E.K.** se **C.D.** po nisej, kështu që **E.K.** do të kishte informata për lëvizjen e **C.D.**, duke e drejtuar kështu **E.K.** që të gjuajë në **C.D.**. **E.K.** më 24.10.2009, rreth orës 19:00 në fshatin Shupkovc, në kryqëzimin e rrugëve "Kalabria" dhe "Brigada 141", mbi urë, shtiu me pushkë automatike AK-47, numri serik xxxxxx në drejtim të **C.D.**, inspektorin e Agjencisë së veterinarisë dhe të ushqimit të Kosovës, dhe e goditi me dy të shtëna automjetin zyrtar Nissan Terrano, në ngjyrë të bardhë, me pllaka të regjistrimit nr. xxxxxx, në të cilën **C.D.** po largohej nga Mitrovica në drejtim të Prishtinës;

I. Duke bërë kështu, i akuzuari **S.B.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale **të pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve**, nga neni 328 (1) të LPK-së.

Sepse **S.B.** ishte në posedim të armës, pushkë kjo automatike AK-47, me numrin serik xxxxxx, pa leje të vlefshme;

II. Duke bërë kështu, i akuzuarit S.B. ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve, në bazë të nenit 328 (2) të LPK-së;

PRANDAJ, i akuzuari S.B.

DËNOHET

Me katër (4) vjet burgim për **veprën penale të pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve**, nga neni 328 (1) të LPK-së (Pika I);

dhe

Me dy (2) vjet burgim për veprën penale të paautorizua **veprën penale të pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve**, nga neni 328 (2) të LPK-së (Pika II).

Dënimi unik caktohet me katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim, në bazë të nenit 71 (1) dhe paragrafi (2) 2 pika e LPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim nga 04.12.2009 deri më 17.08.2010 dhe më pas nën arrest shtëpiak do të llogaritet në pajtim me nenin 73 paragrafi (1) të LPK-së.

Arma – pushka automatike AK-47, numri serik xxxxxx , me anë të këtij aktgjykimi i konfiskohet sipas nenit 60 paragrafi (1) dhe nenit 328 paragrafi (5) i LPK-së.

Dy të akuzuarit do t'i paguajnë pjesët e tyre të shpenzimeve të procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) të KPPK, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do ta lëshojë gjykata, kur të dhënat e tilla të jenë mbledhur në pajtim me nenin 100 paragrafi (2) të KPPK.

ARSYETIM

I. RRETHANAT PROCEDURALE

Më 18.02.2010, prokurori publik i Qarkut për Mitrovicë, Xhevdet Bislimi ngriti Aktakuzën

nr. 404/09, pranë regjistrit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës.

Sipas aktakuzës, i akuzuari *E.K.* u akuzua për veprat penale të tentim vrasjes së rëndë, neni 147 pika 10 në lidhje me nenin 20 të LPK-së, dhe pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve, nga neni 328 paragrafi (2) e LPK-së. I akuzuari *S.B.* u akuzua për veprat penale të nxitjes për kryerjen e tentim vrasje së rëndë, neni 147 pika 10 në lidhje me nenet 20 dhe 24 të LPK-së, dhe i pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve, neni 328 paragrafi (2) e LPK-së.

Aktakuza u konfirmua më 17.03.2010 nga gjyqtari për konfirmim të aktakuzës Ferit Osmani.

II. JURISDIKSIONI I GJYKATËS

2.1. Juridiksioni lëndor dhe ai territorial

Sipas nenit 23 (1) të KPPK, gjykata e qarkut ka juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë një vepër penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet ose me burgim afatgjatë. Veprat penale që janë objekt i akuzave lejojnë burgim prej së paku pesë vjet.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka pasur juridiksion lëndor mbi rastin.

Veprat penale në akuzë thuhet se janë kryer në fshatin Shupkovc, Komuna e Mitrovicës si dhe në Mitrovicë¹. Prandaj, pajtim me nenin 27 (1) të KPPK, Gjykata e Qarkut të Mitrovicë ka pasur gjithashtu juridiksion territorial mbi rastin.

2.2. Juridiksioni i gjyqtarëve të EULEX-it

Neni 3.3 i Ligjit No.03/L-053 "Për juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin lëndëve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë" thekson se në rastet e kompetencës plotësuese, gjyqtarët e EULEX-it mund të marrin përsipër një rast pas emërimit nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it. Më 02.08.2010, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, me kërkesën e avokatit mbrojtës së *S.B.*, avokatit *E*, vendosi që për këtë lëndë t'i caktojë gjyqtarët e EULEX rast të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës.

¹ Aktakuza PP. Nr. 404/09, faqja 1-3 (përkthimi në gjuhën angleze)

III. LIGJI NË FUQI

3.1. Ligji i aplikueshëm material

Ligji material i aplikueshëm për rastin është ai në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale. Në tetor 2009, dhe në 24.10.2009, kur veprat e supozuara penale janë kryer, në fuqi ishte Kodi Penal i Kosovës (KPK).

3.2. Ligji i aplikueshëm procedural

Ligji procedural i aplikueshëm është ai i cili është në fuqi në kohën kur zhvillohet procedura. Në kohën e procedurës gjyqësore në fuqi ka qenë i Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Prandaj, gjykata e ka ndjekur procedurën në bazë të KPPK.

IV. PERMBLEDHJA E PROVAVE TË PARAQITURA

4.1. Personat e mëposhtëm janë marrë në pyetje si dëshmitarë gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor:

- 1) Pala e dëmtuar *C.D.*, më 17.01.2010
- 2) *E.G.*, kolege e palës së dëmtuar *C.D.* dhe person të cilin e njeh i akuzuari *S.B.*, më 17.11.2010
- 3) *B.D.*, vëllai i palës së dëmtuar *C.D.*, më 17.11.2010
- 4) *L.M.*, vëllai i gruas së të akuzuarit *S.B.*, më 18.11.2010
- 5) *M.N.*, oficer i policisë, më 19.11.2010
- 6) *M.P.*, oficer i policisë, më 23.11.2010
- 7) *M.R.*, oficer i policisë, më 23.11.2010
- 8) *M.S.*, oficer i policisë, 30.11.2010

4.2. Dokumentet e mëposhtme janë paraqitur për tu përdorur si dëshmi nga ana e Prokurores publik të EULEX-it Neeta Amin, dhe janë marrë parasysht si të lexuara në procesverbal në bazë të marrëveshjes nga palët²:

- 1) Fleta mbuluese e dosjes policore, numri i rasteve 2009-BI-343
- 2) Akuzat penale, 05.12.2009, numri i rastit 2009-BI-343
- 3) Deklarata e *C.D.* tek Policia e Kosovës, 24.10.2009, numri i rasteve 2009-BC-2254³

² Procesverbal i shqyrtimit kryesor 18.11.2010, fq 17-19 (versioni në gjuhën angleze)

³ Në deklaratë numri i lëndës ka qenë i shënuar 2008-BC-2254

- 4) Proceseverbali i marrjes në pyetje të viktimës-dëshmitarit C.D. , Policia e Kosovës, 26.10.2009
- 5) Procesverbali i marrjes në pyetje të viktimës-dëshmitarit C.D. , Policia e Kosovës, 10. 11 2009, numri i rastit 2009-BI-343
- 6) Procesverbali i marrjes në pyetje të viktimës-dëshmitarit C.D. , Policia e Kosovës, 04.12.2009, numri i rastit 2009-BI-343
- 7) Intervistë e C.D. para prokurori publik të qarkut, 20.01.2010, PP nr.404/2009
- 8) Deklarata e E.K. në Policinë e Kosovës, 04.12.2009, numri i rasteve 2009-BI-343
- 9) Deklarata e S.B. në Policinë e Kosovës, 04.12.2009, numri i rastit 2009-BI-343
- 10) Raporti i ekzaminimit balistik, data e marrjes 29.01.2010, data e ekzaminimit 03.03.2010, numri i referencës 2009-BI-343
- 11) Parashtrësia e avokatit C në emër të C.D. , 02.11.2010, ku të bashkangjitura gjinden: tri fletë pranime nga Qendra klinike universitare e Kosovës, të lëshuar për C.D. , 30.12.2009, 06.01.2010, 12.01.2010 dhe tre raporte nga Klinika psikologjike, 30.12.2009, 06.01.2010, 12.01.2010
- 12) Memorandum i prokurorit Jusuf Mejzini, 11.03.2010, PPN. Nr. 12/10
- 13) Parashtrësia e C.D. për prokurorin publik, 08.03.2010, PP nr.404/2009
- 14) Parashtrësia e C.D. në lidhje me aktakuzën PP nr.404/2009, 08.03.2010
- 15) Autorizim për ndërmarrje të veprimeve hetimore e të prokurorit publik Xhevdet Bislimi, 29.03.2010, PP nr.404/09
- 16) Raporti fillestar i incidentit, 24.10.2009, 26.10.2009, numri i rastit 2009-BC-2254, numri i referencës 2009-BI-343
- 17) Leja e shoferit e C.D. , xxxx ; dokumenti i regjistrimit të automjetit, xxxx
- 18) Raporti i policit , 24.10.2009, numri i rastit 2009-BC-2254
- 19) Raport nga lokacioni i incidentit nga rreshter dhe zyrtari i forensikës , 24.10.2009
- 20) Foto album, 09-117, 24. 10.2009, 25.10. 2009, nga policia
- 21) Raport i ekzaminimit të vendit të ngjarjes, Njësia rajonale e forensikes Mitrovicë dosja e forensikës 09-117, hartuar nga , mbikëqyrës
- 22) Lista e thirrjeve telefonike IPKO, 30.11.2009⁴
- 23) Memorandum i M.N. dërguar Prokurorit Publik, Prokuroria e ka pranuar më 20.11.2009
- 24) Raporti Flash, 24.10 2009, numri i rastit 2009-BC-2254
- 25) Shënime të qendrës së mbajtjes, për S.B. , 04.12.2009⁵
- 26) Kërkesa për ekspertizë balistike të prokurorit publik të qarkut të Mitrovicës,

⁴ Për listën e thirrjeve telefonike të IPKO's është marrë vendim që të trajtohet si provë e pranueshme në seansën e 23.11.2010. Procesverbali I shqyrtimit kryesor 23.11.2010, faqja 13, 14 (versioni në gjuhën angleze)

⁵ Për shënimet e qendrës së mbajtjes është marrë vendim që të trajtohen si provë e pranueshme më vonë gjatë seansës më 18.11.2010. Procesverbal I seansës kryesore 18.11.2010, fq 39,40 (versioni në gjuhën angleze)

13.01.2010, PP nr.404/2009

27) Kërkesë për kontroll të armëve e prokurorit publik të Qarkut të Mitrovicës ,
16.12.2009

V. VLERËSIMI I PROVAVE TË PARAQITURA

5.1. Konstatimet e gjendjes faktike

Bazuar në dëshmitë e prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata i konsideroi si të vërtetuara me prova faktet e mëposhtme:

Dikur para datës 24.10.2009, i akuzuari *S.B.* ka folur me të akuzuarin *E.K.* lidhur me të shtënat që do t'i ndodhnin palës së dëmtuar *C.D.*, inspektor ky në Agjencinë e veterinarisë dhe të ushqimit të Kosovës. *S.B.* i kërkoi *E.K.* të përdorë armë kundër *C.D.*, dhe premtoi gjithashtu se do ia paguajë *E.K.* një shumë të caktuar parash për këtë. Dy ditë para datës 24.10.2009, në Mitrovicë, *S.B.* ia siguroi *E.K.* pushkën automatike AK-47, numri serik *xxxxxx*, që armën ai ta përdorë kundër *C.D.*. Më 24.10.2009, rreth orës 18:50, *C.D.* po e lëshonte punën tij në terminal doganor në Mitrovicë, në automjetin zyrtar Nissan Terrano, i ngjyrës së bardhë, me pllaka të regjistrimit *xxxxxx*. *S.B.* në atë kohë ishte i pranishëm në terminalin doganor dhe pa *C.D.* duke e lëshuar punën. *S.B.* e thirri në telefon për *E.K.* dhe e informoi *E.K.* se *C.D.* ishte nisur. Si zakonisht, *C.D.* u nis me automjetin zyrtar drejt Prishtinës. *E.K.* po e pritte *C.D.* që të kalonte në fshatin Shupkovc, në kryqëzimin e rrugëve "Kalabria" dhe "Brigada 141". Kur *C.D.* erdhi në atë kryqëzim të rrugëve, mbi urë, *E.K.* shtiu në drejtim të *C.D.* dhe e goditi me dy të shtëna në pjesën e pasme të automjetit.

5.2. Dëshmitë me të cilat është konstatuar gjendja faktike

1) Deklaratat e të akuzuarve në lidhje me veprat penale

Një rol të rëndësishëm në procedimet penale kanë pasur deklaratat e të akuzuarve *E.K.* dhe *S.B.*, të datës 04.12.2009, dhënë para Policisë së Kosovës.

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor të dy të akuzuarit mohuan çdo gjë çka ishte regjistruar në ato deklaratat dhe pohuan se:

- Deklaratat e dhëna para Policisë së Kosovës ishin marrë më forcë dhe se
- Të drejtat nuk u ishin lexuar të akuzuarve para se ata të japin deklaratat si dhe

- Nuk u ishte siguruar ndihma e avokatit mbrojtës.

a. Duke pasur parasysh këto pretendime, gjykata ia kushtoi një pjesë të konsiderueshme të procedurës penale marrjes së tyre në pyetje. Gjykata dëgjoi dëshmitë e punonjësve të policisë të cilët ishin të përfshirë në marrjen e deklaratave nga të akuzuarit si dhe në veprime të tjera të ngjashme. Gjykata vlerësoi se deklaratat ishin marrë në përputhje me procedurën në KPPK:

Së pari, të shprehurit e vullnetit gjatë deklaratave

Sipas nenit 155 (1) dhe nenin 235 të KPPK-së një deklaratë të pandehurit trajtohet si e papranueshme në qoftë se gjatë marrjes në pyetje liria e të pandehurit për të shprehur atë që ai / ajo dëshiron ka qenë e penguar nga keqtrajtimi, ndërhyrje fizike, tortura, shtërngimi, ose në se i pandehuri ka qenë i kërcënuar me masa që nuk janë të lejuara sipas ligjit.

Të shprehurit e vullnetit ti cilin e parasheh dhe KPPK-ja është kërkesë themelore e pranueshmërisë së deklaratave të marra nga i pandehuri. Prandaj, gjykata si duhet i ka vlerësuar pretendimet e të akuzuarve në këtë drejtim.

I akuzuarit **E.K.** ka pohuar se gjatë ekzaminimit të tij në Policinë e Kosovës më 04.12.2009 ai u rrah nga oficerët e policisë M.N. dhe M.R.⁷. **E.K.** ka pohuar se ai kishte qenë i keqtrajtuar shumë, rrahur dhe i detyruar ta nënshkruajë deklaratën. **E.K.** nuk i kishte thënë ndonjë gjë policisë, ata i kishin thënë atij 'thuj këtë e këtë për **S.B.**'; ata gjithashtu i kishin thënë se ai (**E.K.**) kishte shtënë në dikë. Edhe pse **E.K.** e kishte nënshkruar deklaratën, ai e kishte bërë këtë sepse ai nuk mund të duronte rrahjen më.⁸

Më vonë gjatë gjykimit **E.K.** gjithashtu tha se edhe para se të mirret në stacion policor, ai u rrah nga oficerët e policisë M.S. dhe M.R., derisa oficerët e policisë po e mirrin atë në makinë për në stacionin e policisë; të dy oficerët e policisë e kishin rrahur atë gjithashtu edhe në stacionin e policisë⁹.

Gjykata konstatoi se pretendimet e **E.K.** nuk mund të mirren si të vërtetuara dhe se të shprehurit e vullnetit gjatë dhënies së deklaratës nuk ishte shkelur në bazë të kësaj që vijon:

• Oficeri i policisë **M.N.** u mor në pyetje në seancën shqyrtimit kryesor më

⁷ ibid, faqe 25

⁸ ibid, faqet 23-25

⁹ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 30.11.2010, faqet 10-12; procesverbali i shqyrtimit kryesor 23.11.2010, fq. 20 (versioni në gjuhën angleze)

19.11.2010. Ai konfirmoi se ai dhe oficerja e policisë V.Z. ishin të pranishëm derisa po mirrej deklarata e E.K. më 04.12.2009¹⁰. Gjykata i verifikuar nënshkrimet e dy oficerëve të policisë, - M.N. dhe V.Z. ishin në **deklaratën e E.K. dhënë Policisë së Kosovës, 04.12.2009**. M.N. dëshmoi se vetë E.K. e ka treguar S.B. si pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale, nuk ka pasur përdorim të forcës kundër E.K., dhe kurrfarë shenja të dhunës nuk janë parë në E.K., ai nuk u ankua se të ketë qenë i keqtrajtuar¹¹.

• Policët dhe M.R., M.S. u morën në pyetje në seancën e shqyrtimit kryesor, njëri më 23.11.2010, dhe tjetri më 30.11.2010. M.R. dhe M.S. konfirmuan se ata dhe M.N. 04.12.2009 e sollën E.K. në stacionin e policisë. M.R. dhe M.S. e mohuan ta kenë nënshtruar E.K. ndaj ndonjë keqtrajtimit, dhe se ata nuk e kanë parë ndonjë prej kolegëve të tyre duke e keqtrajtuar E.K.¹².

• Gjykata vuri re gjithashtu se nuk kishte asnjë procesverbal se kur E.K. u soll para gjykatësit të procedurës paraprake në **seancën e caktimit të paraburgimit më 05.12.2009** se e kishte ngritur për të gjyqtarit të procedurës paraprake çështjen se ka qenë i keqtrajtuar nga ana e oficerëve të policisë. Një çështje e tillë nuk është ngritur nga E.K. as **seansën e konfirmimit të aktakuzës 17.03.2010**. Sa i përket seansës së paraburgimit më 05.12.2009, E.K. pohoi se ai kishte treguar për rrahjen, por "aty kishte vetëm një nënshkrim dhe vetëm një muaj në paraburgim"¹³. Megjithatë, një deklaratë e tillë e E.K. nuk është shënuar në seancën e paraburgimit. Më tej, çështja e keqtrajtimit nuk ishte ngritur në asnjë fazë tjetër të procedurës penale, as nga E.K. e as nga avokati mbrojtës i tij, deri në fillimin e shqyrtimit gjyqësor. Në pikëpamje të seriozitetit të pretendimeve, gjykata ka pritur që E.K. apo mbrojtës i tij të ngrejë çështjen sa të jipet mundësia e parë dhe jo të presin deri në shqyrtimin kryesor.

Sipas dëshmisë së të akuzuarit S.B., ai ishte rrahur në stacionin e policisë më 04.12.2009 nga oficerët e policisë M.S. dhe M.T.. I akuzuar ka dhënë periudha të ndryshme të kohës lidhur atë se sa kohë kishte zgjatur sulmi, - për një ose një orë e gjysmë, për dy ose dy orë e gjysmë. Ai ishte vazhdimisht u rrah në të dy anët e fytyrës, prapa tij, dhe i goditi gjithashtu me një shishe uji, dhe i kërcënuar me shkopinj. S.B. deklaroi se oficerët e policisë kishin shkruar në deklaratën e tij "çdo gjë që ata dëshironin". Më tej, S.B. në seancën e shqyrtimit kryesor më 18. 11. 2010 pohoi se kanë qenë tre oficerë të policisë të cilët e kishin sulmuar atë, - M.T. dhe dy të tjerë, dhe se ata ishin "

¹⁰ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 19.11.2010, fq. 10, 11 (versioni në gjuhën angleze)

¹¹ ibid. faqet 6, 10, 11, 15

¹² Procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23.11.2010, faqet 18,19; Procesverbali i shqyrtimit kryesor 30.11.2010, faqet 9-12 (versioni në gjuhën angleze)

¹³ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 18.11.2010, fq. 24 (versioni në gjuhën angleze)

kanë pyetjet dhe iu janë përgjigjur pyetjeve vetë"¹⁵.

Në seancën e shqyrtimit kryesor në datën 23.11.2010, i akuzuarit deklaroi se ishte M.R., ai cili që nga momenti kur S.B. mbërriti në stacionin e policisë më 04.12.2009, e kishte mbajtur në paraburgim për "rreth një orë e gjysmë deri në dy orë" dhe se e kishte sulmuar atë¹⁶. Megjithatë, në seancën e shqyrtimit kryesor më 30.11.2010, i akuzuari deklaroi se kishte qenë oficer i policisë M.R. së bashku me oficerin e policisë M.S. të cilët fillimisht e rrahën atë në stacionin e policisë dhe duke e mbajtur atë për pesë deri në gjashtë orë¹⁷.

Gjykata gjeti se pretendimet e lartpërmendura të S.B. nuk mund të vërtetohen dhe se shprehja e vullnetit gjatë dhënies së deklaratës nuk ishte shkëlur në bazë të këtyre arsyeve që vijnë:

- Në vëzhgim të parë, gjykata konsideron se S.B. i kishte dhënë numra të ndryshëm dhe emrat e punonjësve të policisë, që dyshohet ta kenë keqtrajtuar atë, si dhe periudhat e ndryshme kohorë. Si e tillë, pohimit të S.B. i mungon saktësia dhe në pjesë të ndryshme pohimi i tij nuk është konsistent.

- Oficeri i policisë M.R. në seancën e shqyrtimit kryesor më 23.11.2010 ka mohuar çdo presion të jetë përdorur kundër S.B. . M.R. dëshmoi se ai dhe M.S. lokalizuan S.B. më 04.12.2009 dhe ishin të parët që kishin folur me të. S.B. kishte treguar në drejtim të vendit të ngjarjes, ku u braktis arma e cila ishte përdorur për të shtënë në drejtim të palës së dëmtuar. Para se të marrin çfarëdo deklarate nga të akuzuarit, të dy oficerët e policisë shkuan në vendin e ngjarjes për të kërkuar armën. Deklarata e të akuzuarit është marrë më pas, dhe M.R. nuk mori pjesë në të¹⁸. Oficeri i policisë M.S. ka mohuar të jetë përdorur çfarëdo force kundër të akuzuarve duke e përforcuar kështu dëshminë e M.R. për veprimet e ndërmarra më 04.12.2009. Sipas M.S. , hera e fundit ai ishte në kontakt me S.B. më 04.12.2009 ishte në vendin ku u gjet arma¹⁹.

- Sipas deklaratës, oficerët e policisë M.P. , M.N. dhe M.T. morën deklaratën e S.B. .

Oficeri i policisë M.N. në seancën e shqyrtimit kryesor më 19.11.2010 ka mohuar të ketë përdorur forcë apo presion kundër S.B. . Ai konfirmoi se ai dhe dy kolegët e morën deklaratën. M.N. dëshmoi se deklarata është marrë pasi M.S. dhe

¹⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 18.11.2010, fq. 51,52,56 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁶ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 23.11.2010, fq. 18 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁷ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 30.11.2010, fq. 13, 14 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁸ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 23.11.2010, fq. 14-18, 23-25, 27, 30, 31 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 30.11.2010, fq. 4-6, 13-16, 19-21 (procesverbal në gjuhën angleze)

M.R. e kishin lokalizuar *S.B.* më 04.12.2009 dhe se kishin shkuar me *S.B.* për të kërkuar armën²⁰. *M.P.* në seancën e shqyrtimit kryesor më 23.11.2010 konfirmoi se ai, *M.N.* dhe *M.T.* e kanë marrë deklaratën nga *S.B.*. *M.P.* mohoi të ketë përdorur ndonjë presion mbi *S.B.*, dhe se nuk ka parë ndonjë plagë tek *S.B.*. *M.P.* ka marrë pjesë vetëm në marrjen e deklaratës²¹.

- Në bazë të **shenimeve të qendrës për paraburgim, 04. 12.2009**, të cilat u nënshkruan nga *S.B.* (faqja 7 e shënimeve), ishte shënuar se *S.B.* nuk është lënduar apo vuan nga ndonjë sëmundje, dhe ishte shënuar se nuk ishte kërkuar mjeku.

- Gjykata vuri re gjithashtu se nuk kishte asnjë shënim se kur *S.B.* është sjellë para gjyqtarit të procedurës paraprake për seancën e paraburgimit më 05.12.2009 nuk e kishte ngritur para gjyqtarit të procedurës paraprake çështjen e keqtrajtimit nga ana e oficerëve të policisë. *S.B.* në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se ai kishte lëndime në të dy anët e fytyrës së tij edhe në kohën e seansës së paraburgimit²². Sipas **procesverbalit të seancës paraburgimit të datës 05.12.2009**, seanca dëgjimore u mbajt nga gjyqtarja e procedurës paraprake Emine Mustafa, e ndihmuar nga procesverbal mbajtësi Ali Kutllovci, dhe avokatët *E* dhe *G*, dhe prokurori publik Shyqyri Sylja ishin të pranishëm. Megjithatë, sipas procesverbalit të seansës së paraburgimit, as gjyqtari i procedurës paraprake dhe as ndonjë nga palët aty nuk e adresuan çështjen e lëndimeve të supozuara të *S.B.*. Një çështje e tillë nuk u ngrit as nga të akuzuarit as në **seansën e konfirmimit të aktakuzës më 17.03.2010**.

Sa i përket seansës së paraburgimit të datës 05.12.2009, *S.B.* deklaroi se kurrfarë seance dëgjimore nuk është mbajtur fare, se ajo kishte ndoshta vetëm një apo dy minuta; *S.B.* ka qëndruar jashtë sallës së gjyqit në korridor me oficerët e policisë, të cilët e kishin penguar atë që të thotë një fjalë të vetme, dhe se atij nuk i është dhënë asnjë mundësi për të thënë ndonjë gjë²³. Oficeri i policisë *M.N.* në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 19.11.2010 konfirmoi se ai dhe polici *M.R.* e dërguan *S.B.* në seancën e paraburgimit për në gjykatë në Vushtrri. Të dy oficerët e policisë qëndruan jashtë sallës së gjyqit, në korridor dhe ata nuk kanë hyrë në sallën e gjyqit²⁴. Oficeri i policisë *M.R.* në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.11.2010 tërësisht e përforcoi ende dëshminë e *M.N.*²⁵. Sipas **procesverbalit të seancës së paraburgimit, 05.12.2009**, dy të akuzuarit ishin të pranishëm në seancë, seancën zgjati nga ora 13:35 deri në 14:00, dhe të akuzuarit gjithashtu bënë deklaratatë të caktuara gjatë

²⁰ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 19.11.2010, fq. 05-10, 16, 17 (versioni në gjuhën angleze)

²¹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 23.11.2010, fq. 3-7 (versioni në gjuhën angleze)

²² Procesverbal i shqyrtimit kryesor 18.11.2010, fq. 54 (versioni në gjuhën angleze)

²³ ibid. faqet 47, 48

²⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 19.11.2010, fq. 12, 21 (versioni në gjuhën angleze)

²⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 23.11.2010, fq. 17 (versioni në gjuhën angleze)

seancës.

Në bazë të kësaj çfarë u tha më sipër, gjykata gjeti se të shprehurit e vullnetit gjatë dhënies së deklaratave nga të akuzuarit më 04.12.2009 nuk ishte shkelur.

Së dyti, të drejtat të cilat iu lexuan të akuzuarve para deklaratave

Neni 231 paragrafi (2) i KPPK parashikon të drejtat, të cilat duhet t'i lexohen të pandehurit para çdo marrjeje në pyetje. Në bazë të nenit 235 të KPPK, nëse i pandehuri nuk është i informuar për këto të drejta, deklaratat e të pandehurit është e papranueshme. Të akuzuarit *E.K.* dhe *S.B.* pohuan se përpara se ata të japin deklaratat e tyre më 04.12.2009 në policinë e Kosovës të drejtat nuk u ishin lexuar atyre²⁶. Prandaj, gjykata i ka ekzaminuar këto pohime të të akuzuarve

• Gjkata vuri re se në **deklaratat e 04.12.2009**, para Policisë së Kosovës në gjuhën shqipe, paralajmërimi në pajtim me nenin 231 paragrafi (2) të KPPK ishte shënuar në procesverbal. Deklarat janë nënshkruar nga dy të akuzuarit.

• Oficeri i policisë *M.N.*, i cili e ka intervistuar *E.K.* si dhe *S.B.* më 04.12.2009, në seancën e shqyrtimit kryesor konfirmoi se procedura e rregullt në marrjen e një deklaratë nga i pandehuri është që së pari i pandehuri informohet për të drejtat e tij, duke përfshirë aty edhe drejtat për të mbetur në heshtje²⁷.

• Oficeri i policisë *M.P.*, i cili mori pjesë në marrjen e deklaratës së *S.B.* më 04.12.2009, në seancën e shqyrtimit kryesor konfirmoi se ai e kishte parë *S.B.* dhe avokatin e tij duke e lexuar deklaratën. *S.B.* u pyet nëse ai donte të shtonte diçka ose nëse ishte bërë ndonjë padrejtësi. Pas leximit të deklaratës, *S.B.* e ka nënshkruar atë²⁸.

Në pikëpamje të kësaj çfarë u tha më sipër, gjykata vlerësoi se më 04.12.2009, të dy të akuzuarve u është dhënë paralajmërimi si duhet para deklaratave të tyre.

E treta, asistenca e avokatëve mbrojtës

Sipas nenit 231 paragrafi (2) pika 4 dhe paragrafi (3) të KPPK-së, i pandehuri para çdo marrjeje në pyetje duhet të jetë i informuar për të drejtën për të pasur ndihmën e avokatit mbrojtës si dhe të drejtën për t'u konsultuar me të para si dhe gjatë marrjes në

²⁶ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 18.11.2010, fq. 28, 49 (versioni në gjuhën angleze)

²⁷ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 19.11.2010, fq. 5 (versioni në gjuhën angleze)

²⁸ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 23.11.2010, fq. 6, 7 (versioni në gjuhën angleze)

pyetje. Siç mësipër e ka vlerësuar gjykata, të akuzuarit kanë qenë të informuar për këtë të drejtë para deklarimit të tyre. Në shqyrtimin kryesor, **E.K.** pohoi se avokati mbrojtës **G**, i caktuar sipas detyrës zyrtare, erdhi në fund të deklaratës së tij, e nënshkroi deklaratën dhe shkoi²⁹. **S.B.** pohoi se pasi ai kishte qenë i rrahur për gjashtë orë në stacionin e policisë, avokati mbrojtës **E**, i caktuar sipas detyrës zyrtare, erdhi dhe se **S.B.** në atë kohë as që e dinte se ai ishte avokat. Avokati mbrojtës nuk e kishte konsultuar atë fare³⁰.

Gjykata konstatoi se pretendimet e mësipërme e të akuzuarve nuk mund të trajtohen si të vërtetuara në bazë të këtyre arsyeve:

- Asnjëri prej oficerëve të policisë, të cilët janë marrë në pyetje gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor nuk kanë mundur ta thonë saktësisht se kush pikërisht e kishte thirrur avokatin mbrojtës për të ardhur në stacionin e policisë më 04.12.2009. Megjithatë, zyrtari i policisë **M.N.**, i cili e kishte intervistuar **E.K.** si dhe **S.B.**, dëshmoi në gjyqin kryesor që çdo avokati i cili vjen në stacionin e policisë i shpjegohet rasti në të cilin do të marrë pjesë ai. Me tej, **M.N.** konfirmoi se avokati mbrojtës i **E.K.** dhe **S.B.** ishte i pranishëm gjatë gjithë rrjedhës së deklaratave të tyre. Oficeri i policisë **M.P.**, i cili mori pjesë në marrjen e deklaratë së **S.B.**, në shqyrtimin kryesor dëshmoi se avokati **E**, avokat mbrojtës për **S.B.**, arriti para se **S.B.** ta japë deklaratën e vet, ai ka biseduar me **S.B.** dhe tek atëherë i akuzuari kishte dhënë deklaratën.³²

- Gjykata vërtetoi se në deklaratat e datës 04.12.2009 kane qenë nënshkrimet avokatëve **E** dhe **G**.

- Më tej, gjykata vlerësoi se pas deklaratave të dy avokatët vazhduan t'i përfaqësojnë të akuzuarit. Në seancën e paraburgimit më 05.12.2009, avokati **E**, avokat mbrojtës i **S.B.**, dha argumente në emër të klientit të tij se nuk kishte rrezik të ikjes ose të ndikimit tek **C.D.**, meqë **S.B.** e kishte pranuar tërësisht veprën penale duke shprehur keqardhje, dhe premtoi se ai nuk do të angazhohet në vepra penale në të ardhmen³³. Gjithashtu Avokati **G**, avokat mbrojtës i **E.K.**, kërkoi caktimin e një mase tjetër kundër klientit të tij. Gjithashtu, Avokati **E** më 10.08.2010 paraqiti kërkesë-propozim gjykatës që **S.B.** t'ia ndërprejë paraburgimin dhe që t'ia shqiptojë masën e dorëzimit në vend.

Në pikëpamje të shqyrtimeve të mësipërme, gjykata ka gjetur se i akuzuari kishte marrë ndihmën e duhur të avokatit mbrojtës.

²⁹ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 18.11.2010, fq. 23 (versioni në gjuhën angleze)

³⁰ ibid. p.37

³² Procesverbali i shqyrtimit kryesor 23.11.2010, fq. 3 (versioni në gjuhën angleze)

³³ Procesverbali i shqyrtimit kryesor 05.12.2009, fq. 2 (versioni në gjuhën angleze)

Një çështje tjetër që është ngritur nga avokati *B*, avokat mbrojtës i *S.B.*, ishte se kishte mospërputhje përsa i përket orës së shënuar në **deklaratën** e *S.B.* të datës **04.12.2009**. Në veçanti, sipas deklaratës, intervista ka filluar në orën 16:44 dhe ka përfunduar në orën 15:45. Për më tepër, bazuar në Shënimet e qendrës së mbajtjes, për *S.B.*, 04.12.2009, i akuzuari *S.B.* ishte arrestuar në orën 16:00. *M.N.* ka pohuar në shqyrtimin kryesor se janë bërë gabime lidhur me orën e saktë, kur ka filluar dhe përfunduar intervista, por ajo që ishte relevante ishte ora e arrestimit.³⁴ Duke pasur parasysh dëshmitë e oficerëve të policisë të trajtuara në këtë aktgjykim, gjykata nuk ka pasur dyshime lidhur me faktin se *S.B.* kishte dhënë deklaratë. Dëshmitë e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor kanë konfirmuar se me datë 04.12.2009 *S.B.* ka dhënë deklaratë në policinë e Kosovës. Për këtë arsye, mospërputhjet lidhur me orën e shënuar në deklaratë nuk mund të sjellin në përfundimin se deklarata nuk është dhënë nga i akuzuari dhe ato nuk e bëjnë deklaratën të pavlefshme.

Duke pasur parasysh këtë, gjykata vlerësoi se deklaratat e të akuzuarve *E.K.* dhe *S.B.*, të datës 04.12.2009, të dhëna në policinë e Kosovës nuk deklarohen të papranueshme dhe si të tilla mbesin në prova. Gjykata vazhdoi me ekzaminimin e përmbajtjes së deklaratave.

b. *E.K.* ishte i dyshuari i parë i identifikuar nga policia e Kosovës. Ai është ekzaminuar nga policia e Kosovës me datë 04.12.2009. **Në Deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës me datë, 04.12.2009**, *E.K.* ka thënë se ai nje *S.B.* që prej fëmijërisë. Në deklaratën e tij *E.K.* nuk ka dëshmuar se me datë 24.10.2009 ai ka shtënë në *C.D.*. Ai bëri shenjë në drejtim të *S.B.*, se ky i fundit ka ardhur tek ai rreth dy (2) muaj përpara dhe ka kërkuar që të vjedhë një Jeep të një zyrtari të doganave me të cilin *S.B.* kishte probleme. Edhe pse *E.K.* është pajtuar të bëjë këtë për 300 euro, kjo marrëveshje nuk është zbatuar. Më vonë *S.B.* ka shkuar përsëri tek *E.K.* dhe i ka ofruar 500 euro për të shtënë me arme në një zyrtar të doganave. *S.B.* ka premtuar të gjejë një armë për këtë qëllim, megjithatë *E.K.* ka refuzuar. Më vonë *S.B.* i ka thënë *E.K.* se ai kishte kryer punën.

c. Pasi që *E.K.* ka treguar *S.B.*, policia e Kosovës ka kontaktuar *S.B.*. Në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës me datë 04.12.2009, *S.B.* ka konfirmuar se ai kishte probleme me *C.D.*, sepse *C.D.* po i mernte para atij për të mbaruar punën. Në këtë mënyrë *S.B.* ka kërkuar *E.K.* që të përdorë armën kundër *C.D.* dhe

³⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor i datës 19.11.2010, pp. 13, 16-18 (versioni në gjuhën angleze)

dy ditë me parë, 24.10.2009, ai i ka siguruar *E.K.* në shtëpinë e tij në Mitrovicë një armë, Kalashnikov. Me datë 24.10.2009, *S.B.* ishte në terminalin e doganës në Mitrovicë. Pasi që *S.B.* ka parë *C.D.* duke u larguar me veturë nga terminali i doganës, rreth orës 19:00, *S.B.* ka informuar përmes telefonit *E.K.*, i cili ishte duke pritur që të kalonte *C.D.*. Ndërsa *S.B.* ishte në një restorant afër terminalit të doganës, ai ka dëgjuar të shtënat. Pas të shtënave, *E.K.* ka thirrur në telefon *S.B.*, por *S.B.* nuk është përgjigjur sepse kishte frikë se *E.K.* mund të kishte vrarë *C.D.*. Të nesërmen *S.B.* ka takuar *E.K.*, i cili i ka thënë se kishte shtënë në *C.D.* por nuk e kishte vrarë sepse *C.D.* kishte vazhduar të voziste. *S.B.* i ka dhënë *E.K.* 200 EUR. Të nesërmen *S.B.* ka marrë armën, Kalashnikov, të cilën e ka çmontuar dhe e ka hedhur në disa shkurre në fshatin Koshtovë pas tre javësh.³⁵

Për këtë arsye, ***S.B.* në deklaratën e dhënë në policinë e Kosovës me datë, 04.12.2009**, ka treguar përfshirjen e *E.K.* në të shtënat kundër *C.D.*. Për më tepër, *S.B.* ka dëshmuar se ka qenë në posedim të një arme, Kalashnikov, i cila është përdorur më vonë nga *E.K.* kundër *C.D.* me datë 24.10.2009.

2) Prova të tjera lidhur me kryerjen e veprave penale nga *E.K.* dhe *S.B.*

Në pajtim me nenin 157 paragrafi (2) i KPPK-së, gjykata nuk do të shpallë të akuzuarin fajtor bazuar vetëm apo në mënyrë vendimtare në deklaratat e dhëna nga i pandehuri në polici apo prokurori.

Për këtë arsye gjykata ka marrë parasysh, lidhur me deklaratat e të akuzuarit të dhëna në policinë e Kosovës me datë 04.12.2009, dëshmitë e dëshmitarëve dhe prova të tjera të paraqitura nga Prokurori Publik i EULEX-it gjatë shqyrtimit kryesor.

d. **Raporti nga vendngjarja nga rreshteri** dhe zyrtari i forensikës , 24.10.2009, dhe **Raporti** i oficerit të policisë , 24.10.2009, lënda numër 2009-BC-2254, ka siguruar se me datë 24.10.2009, rreth orës 19:15 ata janë njoftuar lidhur me një rast kundër *C.D.* që kishte ndodhur në rrugën kryesore Mitrovicë - Prishtinë. Ata kanë shkuar në vendngjarje. Ata janë afruar oficerëve të doganës në pikën e kontrollit të doganës të cilët thanë se kishin dëgjuar tre – katër të shtëna nga drejtimi i terminalit të doganës por se nuk kishin parë asgjë sepse ishte terr. Më tej, **në raportin e**

³⁵ Gjukata ka identifikuar se versioni i fundit i përkthimit në gjuhën angleze i deklaratës së *S.B.*, datë 04.12.2009, dhënë në policinë e Kosovës e cila është siguruar nga Prokurori Publik i EULEX-it, ishte e paplotë në pjesën ku *S.B.* ka dëshmuar lidhur me atë që ka bërë me armën. Në këtë pjesë gjykata ka ndjekur deklaratën në gjuhën shqipe

ekzaminimit të vendngjarjes, Njësia Rajonale e Forensikës në Mitrovicë, dosja e forensikës 09-117, është specifikuar se ngjarja kishte ndodhur me datë 24.10.2009 në rrugën kryesore Mitrovicë – Prishtinë, në fshatin Shupkocv, në urë. Janë bërë fotografi të veturës që *C.D.* kishte qenë duke vozitur mbrëmjen e incidentit. Kjo është deklaruar edhe në **Raportin e shpejtë**, datë, 24.10.2009, lënda numër 2009-BC-2254. Raporti fillestar i ngjarjes, datë 24.10.2009, 26.10.2009, lënda numër 2009-BC-2254, numër reference 2009-BI-343, ka specifikuar më tej vendin e ngjarjes në kryqëzimin e rrugëve 'Kalabria' dhe 'Brigada 141'.

Gjykata ka vlerësuar se Fotoalbumi, 09-117, 24.10.2009, 25.10.2009, përmbante fotografi të veturës, Nissan Terrano, ngjyrë e bardhë, tabela xxxxxx (fotografi numër 5), të cilën voziste *C.D.*. Fotografitë (numër 6-20) tregojnë:

- Një vrimë hyrëse në anën e majtë të veturës, afër dritares së pasme dhe një dritare të thyer në ulësen e pasme, në anën e djathtë të veturës. Trajektorja tregon dalje përmes dritares së ulëses së pasme, në anën e djathtë të veturës.
- Një tjetër vrimë hyrëse gjendej në anën e majtë të veturës, në dritaren e ulëses së pasme me vrimë dalje në anën e djathtë të kupolës së veturës, mbi ulësen e pasme.

Për këtë arsye, provat e marra parsysh më lart, kanë konfirmuar përtej dyshimit të arsyeshëm pjesën e **deklaratës së S.B.**, **04.12.2009**, - se me datë 24.10.2009, rreth orës 19:00, në rrugën kryesore Mitrovicë - Prishtinë, është shtënë me armë në drejtim të *C.D.*, ndërsa ai po voziste veturën në drejtim të Prishtinës. Provat e përmendura më lart identifikojnë se vetura është qëlluar me dy predha dhe specifikojnë vendin ku vetura është qëlluar nga dy të shtëna.

e. Nga dëshmia e palës së dëmtuar *C.D.* rrjedh se me datë 24.10.2009, rreth orës 19:00, në rrugën kryesore Mitrovicë - Prishtinë, ndërsa po kalonte në urë, ai ka dëgjuar një zhurmë të madhe, një të shtënë, dhe ka parë se dy dritare në pjesën e pasme të veturës ishin thyer. Ai gjithashtu dëshmoi se kishte mbaruar punën e tij rreth orës 18:50 dhe se përpara se të largohej nga puna, në terminalin e doganës në Mitrovicë, ai ka ndezur veturën dhe ka përshëndetur punëtorë të tjerë në terminalin e doganës si dhe të akuzuarin *S.B.* ³⁶

³⁶ Procesverbali nga seanca e shqyrtimit kryesor 17.11.2010, fq.6-8, 12, 14 (në gjuhën angleze); Deklarata ishte në përputhje me **deklaratën e C.D. dhënë përpara prokurorit publik të qarkut** me datë 20 janar 2010

Kjo përputhet me deklaratën e datës 04.12.2009, e *S.B.* dhënë në policinë e Kosovës, se me datë 24.10.2009 ai ishte në terminalin e doganës në Mitrovicë, dhe rreth orës 19:00 ai ka parë *C.D.* duke ndezur makinën dhe duke u nisur në drejtim të Prishtinës. *S.B.* pastaj ka informuar në telefon *E.K.* se *C.D.* ishte nisur.

f. **Raporti i ekzaminimit të balistikës**, data e pranimit 29.01.2010, data e ekzaminimit 03.03.2010, numri referencë 2009-BI-343, përmbante rezultate të ekzaminimit vetëm për një pjesë të pushkës automatike AK-47, prodhuar në Kinë, numër serik xxxxxx . Raporti arriti në përfundimin se pa pjesë të tjera të pushkës automatike ishte e pamundur të bëhej testi i qitjes. Gjithashtu, oficerët e policisë **M.S.** dhe **M.R.** kanë dëshmuar në shqyrtimin kryesor se ata kanë qenë në rrugën Mitrovicë – Zubin Potok, në vendin ku janë gjetur pjesë të armës. Nga dëshmitë e tyre nuk ka qenë e mundur të gjendet me saktësi sa pjesë janë gjetur. Sipas dëshmitarëve ata ishin duke kërkuar armën përgjatë rrugës, në grupe dhe bashkë me persona nga forensika dhe oficerë të tjerë të policisë.³⁷ Fotografitë e bëra në vend tregojnë pjesë të një pushke automatike, përfshirë strukturën e armës e cila dukej njësoj me atë në fotografinë e raportit të ekzaminimit të balistikës.

Në këtë mënyrë, nga provat e vlerësuara më lart, është identifikuar se pushka automatike AK-47 ishte çmontuar përpara se të hudhej diku gjatë rrugës Mitrovicë – Zubin Potok. Lidhur me këtë, gjykata në deklaratën e tij të datës 04.12.2009 të dhënë në polici, *S.B.* ka dëshmuar se pasi që ai ka marrë armën nga *E.K.*, ai e ka çmontuar atë dhe e ka hedhur në fshatin Koshtovë. Ky fshat gjendet në rrugën Mitrovicë – Zubin Potok, ku janë gjetur pjesë të armës.

g. **E.K.** në deklaratën e dhënë në polici me datë 04.12.2009, nuk ka dëshmuar se ka shtënë në *C.D.* me datë 24.10.2009. *E.K.* deklaroi se më parë ai kishte refuzuar një ofertë nga *S.B.* për të shtënë në një zyrtar të doganës. Ndërsa *S.B.* në deklaratën e dhënë me datë 04.12.2009, ka dëshmuar se *E.K.* ishte pajtuar që të qëllojë me armë në *C.D.* dhe me datë 24.10.2009 ishte *E.K.* ai që priste që *C.D.* të kalonte për të shtënë në të.

Gjykata gjeti nga provat e paraqitura nga prokurori publik i EULEX-it se nuk ishte e mundur për *S.B.* të shihte *C.D.* duke u larguar nga puna në terminalin e doganës në Mitrovicë me datë 24.10.2009, rreth orës 19:00, dhe të jetë në të njëjtën kohë në një pozicion në kryqëzimin e rrugëve 'Kalabria' dhe 'Brigada 141' për të pritur që *C.D.* të

³⁷ Procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor datë 23.11.2010, fq.16, 18, 23, 24, 29, 30; Procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor datë 30.11.2010, fq.6, 7, 18, 19, 24 (në gjuhën angleze)

kalonte dhe të qëllonte me armë në drejtim të tij. Për këtë arsye, ka qenë një person tjetër që ka shtënë në drejtim të C.D.

Sipas deklaratës së S.B. dhënë në polici me datë 04.12.2009, E.K. i kishte thënë atij të nesërmen e incidentit se pasi që ai kishte shtënë në C.D. ai kishte parë se vetura e C.D. vazhdonte të ecte. Meqënëse S.B. nuk ishte në vendin e të shtënave, ishte e pamundur që ai të dinte nëse C.D. ka vazhduar të vozisë apo nëse ai është ndalur në vend për të zbuluar se çfarë kishte ndodhur dhe për të thirrur policinë nga vendngjarja apo nga afër vendit të ngjarjes. Për më tepër, siç ka dëshmuar C.D. në shqyrtimin kryesor, ai as nuk ishte i sigurtë se çfarë kishte ndodhur me saktësi dhe në atë çast ai nuk ka dyshuar se dikush kishte shtënë në të dhe ka menduar se ishte ndonjë shpërthim.³⁸ C.D. ka dëshmuar se pas incidentit ai ka vazhduar të vozisë dhe ka arritur në stacionin e policisë për të raportuar ngjarjen. Gjithashtu, raporti nga vendngjarja, i përpiluar nga rreshter dhe oficeri i forensikës, 24.10.2009, thotë se C.D. ka arritur në stacionin jugor të policisë në Mitrovicë me veturën e dëmtuar.

Gjykata vlerëson se pa qenë në kryqëzimin e rrugëve 'Kalabria' dhe 'Brigada 141' me datë 24.10.2009, kur ka ndodhur incidenti, E.K. nuk do të kishte mundur të jepte S.B. kaq detaje lidhur me incidentin.

Për këtë arsye, bazuar në elementet ndërlidhës të vlerësuar më lart, gjykata gjeti se me datë 24.10.2009 rreth orës 19:00, në kryqëzimin e rrugëve Kalabria dhe Brigada 141, në urë, E.K. ka shtënë në drejtim të C.D. dhe ka qëlluar me dy predha veturën zyrtare me të cilën C.D. largohej në drejtim të Prishtinës.

h. Në shqyrtimin kryesor, pala e dëmtuar C.D. ka deklaruar se edhe nëse ai dyshon në S.B. dhe E.K., shtytësi i vërtetë ishte dikush tjetër.³⁹ Përveç kësaj, si rezultat i këtij incidenti C.D. ka pasur probleme psikologjike dhe ka pasur nevojë për ndihmën e një psikologu.⁴⁰

Gjatë fazës fillestare të procedurës penale C.D. ka deklaruar se nuk dyshonte askënd lidhur me incidentin e datës 24.10.2009, ai nuk kishte ndonjë mosmarrëveshje me të akuzuarin S.B. . Më vonë C.D. ka deklaruar se S.B. nuk mund të ishte shtytësi i vërtetë dhe se pas veprës penale kundër tij qëndronte dikush tjetër. C.D. ka përshkruar natyrën e punës së tij dhe ka treguar persona me të cilët ka pasur kontakte

³⁸ Procesverbal i seancës së shqyrtimit kryesor datë 17.11.2010, f.8 (në anglisht)

³⁹ ibid, fq.10

⁴⁰ Parashtrësë e avokatit C në emër të C.D., 02.11.2010, me: tre **Fatura** nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, lëshuar për C.D. me datë, 30.12.2009, 06.01.2010, 12.01.2010 dhe tre **raporte** nga psikologu i klinikës, 30.12.2009, 06.01.2010, 12.01.2010

lidhur me punën e tij.⁴¹ Në kërkesat e parshtruara përpara prokurorit publik, C.D. ka kërkuar të zhvillohet një hetim i plotë, që të intervistohen persona të tjerë dhe që të ndërmerren veprime hetuese të mëtejshme.⁴² Megjithatë, gjykatës nuk i janë paraqitur prova të tjera që do ta lejonin atë të ekzaminojë pretendimet e ngritura nga C.D. .

Megjithatë, gjykata ka thirrur *ex officio* disa dëshmitarë. Në shqyrtimin kryesor të datës 17.11.2010 është ekzaminuar E.G. , kolege e C.D. . Sipas dëshmisë së saj, E.G. njihje të akuzuarin S.B. prej më shumë se dy vitesh, zyrtarisht dhe privatisht. Ata ishin takuar disa herë dhe E.G. kishte marrë S.B. në veturën e saj zyrtare. E.G. ishte e habitur kur ka kuptuar dyshimet kundër S.B. , dhe nuk ka njohur të akuzuarin tjetër E.K. .⁴³

Gjykata ka vlerësuar se dëshmia e E.G. nuk ka siguruar ndonjë të dhënë lidhur me ndonjë shtytës tjetër siç mendohet nga pala e dëmtuar.

i. Megjithatë, gjykata ka konstatuar se E.G. ishte informuar se me iniciativë të kunatit të S.B. , L.M. , ishin dërguar njerëz në familjen e C.D. për të kërkuar pajtim, pas arrestimit të S.B. .⁴⁴ Kjo ka konfirmuar dëshminë e C.D. i cili ka deklaruar se janë dërguar disa njerëz tek vëllezërit e tij për të kërkuar falje për S.B. . Përveç kësaj, motra e S.B. kishte thirrur C.D. duke qarë dhe duke kërkuar falje për atë që kishte ndodhur.⁴⁵ Më tej, L.M. , vëllai i gruas së të akuzuarit S.B. , ka konfirmuar në shqyrtimin kryesor se kishte qenë iniciativë e tij për të dërguar njerëz në familjen C.D. për pajtim lidhur me aktin e të akuzuarit S.B. . Edhe pse gjatë ekzaminimit të tij L.M. nuk specifikoi se për çfarë akti të S.B. ne veçanti kërkohej pajtim, ai gjithashtu deklaroi se kur kishte kuptuar se çfarë kishte ndodhur ai kishte vlerësuar të nevojshme afrimin me familjen C.D. për falje.⁴⁶

Nga dëshmitë e lartpërmendura gjykata nuk ka mundur të arrijë në asnjë përfundim lidhur me faktin nëse, siç pretendohet nga C.D. , dikush tjetër ishte i përfshirë në incidentin e datës 24.10.2010 kundër tij, përveç E.K. dhe S.B. . Bazuar në dëshmi,

⁴¹ **Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit-viktimës C.D.** , policia e Kosovës, 26.10.2009; **Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit-viktimës C.D.** , policia e Kosovës, 10.11.2009, lënda numër 2009-BI-343; **Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit-viktimës C.D.** , policia e Kosovës, 04.12.2009, lënda numër 2009-BI-343; Dhe, **intervista e C.D.** përpara prokurorit publik të Qarkut, 20.01.2010, PP nr.404/2009

⁴² **Parashtresë e C.D.** për Prokurorin Publik, 08.03.2010, PP nr.404/2009; **Parashtresë e C.D.** lidhur me aktakuzën PP nr.404/2009, 08.03.2010

⁴³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 17.11.2010, fq.22, 23, 27, 28, 33 (në anglisht)

⁴⁴ ibid, fq.33

⁴⁵ ibid, fq.20

⁴⁶ Procesverbal i shqyrtimit kryesor 18.11.2010, fq.5-7, 11 (në anglisht)

gjykata arriti në përfundimin se familja C.D. ishte kontaktuar për pajtim në emër të të akuzuarit S.B. . Duke pasur parasysh një zakon që vazhdon të ndiqet në disa vende të Kosovës ku pas një aktiviteti kriminal kërkohet pajtim mes familjeve përmes njerëzve të vjetër dhe të respektuar, këto dëshmi nuk mund të interpretohen si indikacione në drejtim të të akuzuarit S.B. në kryerjen e veprës penale kundër C.D. .

VI. CILËSIMI JURIDIK I AKTEVE TË TË AKUZUARVE

6.1. Cilësimi ligjor i veprimit të E.K.

E.K. sipas aktakuzës PP nr. 404/09 akuzohej për Vrasje të Rëndë në Tentativë, nga neni 147 pika 10 lidhur me nenin 20 KPK dhe Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve nga neni 328 paragrafi (2) i KPK-së.

Së pari, akuza e Vrasjes së Rëndë në Tentativë, neni 147, pika 10 lidhur me nenin 20 të KPK-së

Së pari, gjykata ka vlerësuar se neni 20 i KPK-së përkufizon Tentativën si veprim i menjëhershëm i qëllimshëm në drejtim të kryerjes së një vepre penale, ku veprimi nuk është përfunduar apo elementet e veprës penale nuk janë plotësuar. Duke pasur parasysh nenin 147 dhe 20 të KPK-së, një Tentativë për të kryer Vrasje të Rëndë kërkon që të ndërmirret veprim i qëllimshëm në drejtim të privimit nga jeta të një personi tjetër. Gjykata gjeti se nuk ka pasur prova bindëse për të arritur në përfundimin se E.K. ka pasur qëllimin të privojë nga jeta C.D. . Provat tregojnë se S.B. i ka kërkuar E.K. të qëllojë me armë në C.D. , mirpo nuk është vërtetuar se qëllimi i shterjes ka qenë për ta vrarë palën e dëmtuar. Andaj Gjykata nuk ka gjetur se në orët e vona, të datës 24.10.2009, qëllimi i E.K. ishte të vriste C.D. . Rrethanat në të cilat E.K., me datë 24.10.2009 ka shtënë në drejtim të C.D. nuk kanë qenë të tilla sa të identifikojnë se E.K. ka dashur apo parashikuar vdekjen e palës së dëmtuar. Provat tregojnë që trajektorja e dy plumbave ka shkuar përmes pjesës së pasme të automjetit nga ulësja e pasme dhe jo shumë afër ulëses së vozitësit të cilat sjellin dyshim se nëse të shtënat kanë pasur për qëllim ta qëllonjë palën e dëmtuar apo vetëm ta kërcënojnë atë duke e goditur veturën e tij. Sipas deklaratës së S.B. të dhënë para policisë, pasi që i ka dëgjuar krismat, ai nuk i është përgjigjur thirrjes telefonike të E.K. , pasi që ka qenë i friguar se mos C.D. është vrarë. Ky është një tregues i mungesës së qëllimit për ta privuar nga jeta palën e dëmtuar. Nga këto arsye gjykata nuk ka mundur përtej dyshimit të bazuar të vërtetoj se qëllimi i E.K. ka qenë ta vrasë C.D. . Për këtë arsye, gjykata ka vlerësuar të panevojshme që të ekzaminohen elementë të tjerë, nga neni 147 pika 10

lidhur me nenin 20 të KPK-së, dhe E.K. është shpallur i pafajshëm dhe është liruar nga kjo akuzë në pajtim me nenin 390 pika 3 të KPPK-së.

Së dyti, akuza për Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve nga neni 328 paragrafi (2) i KPK-së

Gjykata gjeti se E.K., me datë 24.10.2009, rreth orës 19:00 ka përdorur armën, pushkë automatike AK-47, numri serik xxxxxx, në të shtënat në drejtim të C.D., ndërsa ky i fundit ishte duke vozitur në drejtim të Prishtinës, dhe ka qëlluar me dy të shtëna veturën. Nga deklaratat e të akuzuarit të dhëna në polici e Kosovës, gjykata arriti në përfundimin se S.B. kishte probleme me C.D. lidhur me punën e tij dhe kjo ishte arsyeja për të cilën është shtënë mbi të me datë 24.10.2009. Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat është shtënë me armë në drejtim të të dëmtuarit C.D. dhe se vetura është qëlluar nga dy të shtëna, gjykata gjeti se E.K. kishte përdorur armën në mënyrë frikësuese dhe të paautorizuar.

Për këtë arsye ky veprim i E.K. është cilësuar si Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve nga neni 328 paragrafi (1) i KPK-së. Për rrjedhojë E.K. u shpall fajtor për këtë vepër penale.

6.2. Cilësimi ligjor i veprimit të S.B.

Me aktakuzën PP nr. 404/09, S.B. akuzohet me veprën penale shtytje në kryerjen e vrasjes së rëndë, sipas Nenit 147, pika 10 lidhur me Nenet 20 dhe 24, KPK, pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim i armëve, sipas Nenit 328, paragrafi (2), KPK.

Së pari, akuza për shtytje në kryerjen e vrasjes së rëndë, Neni 147, pika 10 lidhur me Nenet 20 dhe 24, KPK.

Siç shihet nga Neni 24, KPK, shtytësi është personi i cili me dashje shtyt tjetrin për të kryer veprën penale. Prandaj, për të kualifikuar veprën e S.B. sipas Nenit 147, pika 10 lidhur me Nenet 20 dhe 24, KPK, së pari duhet përcaktuar se S.B. shtyti E.K. që ta privojë nga jeta C.D. Edhe pse provat përcaktuan se S.B. para datës 24.10.2009 kërkoi nga E.K. që të qëllojë me armë C.D. dhe e pajisi E.K. me armë, për gjykatën kjo nuk ishte e mjaftueshme të mbështesin akuzën e Vrasjes në tentativë, sepse nuk është provuar se qëllimi i asaj shtyerje ishte ta vras palën e dëmtuar. Për më tepër nuk është provuar se S.B. ka pasur në ndonjë moment qëllim për të privuar nga jeta palën e dëmtuar. Rrethanat të cilat janë zgjedhur nga të akuzuarit të shtijnë në drejtim të C.D. nuk ishin të atilla që të themelojnë përtej dyshimit të bazuar se me 24.10.2009, qëllimi i S.B. ishte që E.K. ta vraste C.D. Prandaj gjykata gjithashtu nuk gjeti se në natën e 24.10.2009, qëllimi i E.K., duke verpaur nën ndikimin e S.B. ishte ta vras C.D. Tajektoret e dy të shtënave që depërtuan në pjesën e pasme të veturës nëpërmjet

ulesës së pasme dhe jo shumë afër të ulëses së vozitësit. Gjithashtu S.B. në deklaratën e tij të dhënë në Policinë e Kosovës deklaroi se pasi që ka dëgjuar të shtënat, ai nuk i është përgjegjës thirrjes telefonike të E.K. , sepse ai ishte i friguar që C.D. mund të ishte vrarë. Prokurori Publik nga EULEX në fjalën e saj përfundimtare iu referua ca informatave që S.B. u kishte dhënë zyrtarëve të policisë më 04.12.2009 kur ai u kontaktua nga policia dhe para se të jepte deklaratë. Pasi që informatat e tilla nuk janë inçizuar siç duhet dhe në pajtim me procedurën siç e parasheh KPPK-ja, gjykata duke njohur interesat e hetimit nuk ka mundur të vlerësojë informatat e përmendura. Gjykata nuk ka mundur të përcaktojë përtej çdo dyshimi të bazuar se S.B. kishte nxitur E.K. ta privonte C.D. nga jeta. Prandaj, Trupi Gjykses ishte i mendimit se është e panevojshme të vlerësohen elementet e tjera sipas Nenit 147, pika 10 lidhur me Nenet 20 dhe 24, KPK.

Trupi Gjykses gjeti se veprimi i S.B. i kualifikuar si pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve sipas Nenit 328, paragrafi (1), KPK. S.B. udhëzoi E.K. që të përdorte armën automatike AK-47, me numrin serik xxxxxx kundër C.D. në një mënyrë frikësuese dhe të paautorizuar. Dhe E.K. më 24.10.2009 rreth orës 19:00 ka shtëne me armë në drejtim të C.D. derisa ky po ngiste veturën në drejtim të Prishtinës. Me kaq, S.B. është shpallur fajtor për veprën penale pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve sipas Nenit 328, paragrafi (1), KPK.

Së dyti, akuza për pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve, Neni 328, paragrafi (2), KPK

Trupi Gjykses gjeti se para datës 24.10.2009, S.B. kishte pajisur E.K. me armën automatike AK-47, numri serik xxxxxx . Kështu, S.B. kishte pasur armë të posedim të paautorizuar. Me kaq, Trupi Gjykses shpalli S.B. n fajtor për veprën penale për pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve, sipas Nenit 328, paragrafi (2), KPK.

VII. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

7.1. Dënimi për veprën penale të kryer nga E.K.

Neni 328, paragrafi (1), KPK parasheh dënimin me gjobë deri në 10 000 EUR apo dënimin me burgim prej një deri në dhjetë vjetë. Gjatë përcaktimit të dënit, në pajtim me Nenin 64, paragrafin (1), KPK, Trupi Gjykses mori parasysh rrethanat që kanë ndikim zbutës apo rëndues në dënim. Si rrethanë zbutëse, Trupi Gjykses mori për bazë faktin se para të shtënave në drejtim të C.D. më 24.10.2009, i akuzuari E.K. ishte në

posedim të armës automatike AK-47, me numrin serik xxxxxx për një periudhë prej vetëm dy ditësh. Për më tepër, nuk kishte qenë iniciativë e E.K. që të përdorte armën kundër C.D. . I akuzuari S.B. , i cili për nga niveli i arsimimit dhe gjendja financiare, është më 'i fuqishëm' se E.K., kishte udhëzuar E.K. që të përdorte armën kundër C.D. . Trupi Gjykses poashtu mori në konsideratë se E.K. mban familje prej pesë fëmijëve. Si rrethanë rënduese, Trupi Gjykses konsideroi faktin se E.K. përdori armën në mënyrë frikësuese dhe të paautorizuar kundër personit zyrtar pasi që pala e dëmtuar C.D. në atë kohë ishte edhe inspektor në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës.

Duke pasur parasysh këto që u thanë më lart dhe me qëllim të parandalimit që E.K. të kryen sërish veprat penale, Trupi Gjykses solli vendim për tre (3) vjet burgim për veprën penale pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328, paragrafi (1), KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga 04.12.2009 deri më 17.08.2010 dhe pastaj ajo e kaluar në arrest shtëpiak do të llogaritet sipas Nenit 73, paragrafi (1), KPK.

7.2. Dënimi për veprat penale të kryera nga S.B.

a. Neni 328, paragrafi (1), KPK parasheh dënimin me gjobë deri në 10 000 EUR apo burgim prej një deri në dhjetë vjetë. Gjatë përcaktimit të dënimit, në pajtim me Nenin 64, paragrafi (1), KPK, Trupi Gjykses mori parasysh rrethanat që kanë ndikim zbutës apo rëndues në dënim. Si rrethana zbutëse, Trupi Gjykses mori faktin se S.B. nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër penale.

Si rrethanë rënduese, Trupi Gjykses konsideroi faktin se S.B. udhëzoi E.K. të përdorë armën automatike AK-47, numri serik xxxxxx , në mënyrë frikësuese dhe të paautorizuar kundër personit zyrtar. Pasi që pala e dëmtuar C.D. në atë kohë ishte edhe inspektor i Agjencisë Kosovare të Ushqimit dhe Veterinarisë. Për më tepër, veprimi i S.B. për të udhëzuar E.K. për të përdorur armën kundër C.D. solli pasoja të rënda për C.D. . Në veçanti, C.D. kishte nevojë për ndihmën e psikologut.

Duke marrë parasysh ato që u thanë më lart dhe me qëllim që të pengohet S.B. nga përsëritja e veprave penale, Trupi Gjykses solli vendim për dënim prej katër (4) vjetë burgim për veprën penale pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve, sipas Nenit 328, paragrafi (1), KPK.

b. Neni 328, paragrafi (2), KPK parasheh dënimin me gjobë deri në 7 500 EUR apo burgim prej një deri në tetë vjetë.

Duke pasur parasysh faktin se S.B. nuk është më parë i dënuar për vepër penale, Trupi Gjykues solli vendim për dënim prej dy (2) vjetë burgim për veprën penale pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve sipas Nenit 328, paragrafi (2), KPK.

Dënimi unik prej katër (4) vjetë dhe gjashtë (6) muaj burgim u përcaktua në pajtim me Nenin 71, paragrafi (1) dhe paragrafi (2), pika 2, KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga 04.12.2009 deri më 17.08.2010 dhe pastaj në arrest shtëpiak do të llogaritet sipas Nenit 73, paragrafi (1), KPK.

7.3. *Konfiskimi i armës*

Dënimi dytësor për konfiskimin e armës automatike AK-47, numri serik xxxxxx ishte mandator sipas Nenit 60, paragrafi (1) dhe Neni 328, paragrafi (5), KPK.

VIII. KËRKESË PADIA PRONËSORE-JURIDIKE

Avokati C, përfaqësuesi i autorizuar i C.D. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se nuk dëshiron të ngarkojë procedurën penale me përcaktimin e bazës për kompensimin e dëmeve. Pasi që nuk është nisur procedura për kompensim, Trupi Gjykues nuk solli vendim mbi këtë çështje.

IX. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Që të dy të akuzuarit do të kompensojnë pjesën e tyre të shpenzimeve të procedurës penale sipas Nenit 102, paragrafi (1), KPPK me përjashtim të shpenzimeve për përkthim. Një vendim i veçant mbi shumën e shpenzimeve do të lëshohet nga gjykata kur të pranohen të dhënat në fjalë sipas Nenit 100, paragrafi (2), KPPK.

**Gjykata e Qarkut në Mitrovicë
P nr. 12/2010**

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Procesverbal mbajtës:

Zane Ratniece
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Kryetar i trupit gjykues:

Nikolay Entchev
Gjyqtar i EULEX - it

Anëtarë të trupit gjykues:

Christine Lindemann-Proetel
Gjyqtare e EULEX-it

Klaus Jung
Gjyqtar i EULEX-it

Këshillë juridike: Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, në pajtim me nenin 398, paragrafi (1), KPPK.